



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1198/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Vesna Dimiq kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Partesh nga radhët e subjektit politik Demokratska Iniciativa , paraqitur kundër KQZ-së për shkak të parregullsive dhe të mungesës të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Vesna Dimiq kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radhët e Demokratska Iniciativa dega në Partesh.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Vesna Dimiq kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Partesh nga radhët e subjektit politik Demokratska Iniciativa me të cilën theksohet se Vesna Dimiq kandidate me nr rendor 3 ne listën e Demokratska Iniciativa ne Partesh i ka fituar 42 vota dhe do te duhej te kaloj si deputete por me ketë rast ka ndodhur një gabim duke hyre kandidatja Jasmina Jovanoviq me nr rendor 6 e cila e ka fituar te njëjtin numër te votave dhe si dëshmi përmend rezultatin e publikuar nga KQZ-ja.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova në dëshmi bindëse pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo ndonjë dëshmi bindëse që do ti bënë të besueshme dhe qe do ti vërtetonin pretendimet e tilla ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj

PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1198/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit-Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.